



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKA E KOSOVËS ★ REPUBLIKA KOSOVA

KOSOVA CUMHURİYETİ

Komuna e Prizrenit ★ Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Qendra për Punë Sociale

Centar za Socialni Rad

Sosyal İşler Merkezi

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Ljr Nr 058 Dt 18.04.2025

DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve Ekspert të jashtëm

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve në Nenin 8, paragrafin 3.2 që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhen të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim DPMS-ja fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisioni Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të :

1. Një përfaqësues nga OJQ-të ;

Të drejtë aplikimi kanë :

- Të angazhuar në Organizatat jo-qeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Prizrenit ;
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në shërbime sociale
-

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte :

- Duhet të kenë diplomë universitare ;
- Të ketë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve të OJQ-ve të shërbimeve sociale
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente :

- Një CV ;
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzoj një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë .

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prizrenit
Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies
Sociale
Sporteli nr.:1- 5 në ndërtesën e
Komunës,20000 Prizren

Afati I dorëzimit të dokumentacionit është 7 dit nga dita e publikimit.

Komisioni i themeluar nga DPMS-ja do t'i vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve .

